




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 73/2021
Datë: 24 mars 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragraf 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Riza Livoreka, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj-dega në Kaçanik, sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/32/2020-AD/GJTHFR/ 02/20, të datës 21 janar 2021, pas seancës dëgjimore të mbajtur më datë 4 mars 2021, në pajtim me nenin 14 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, nxjerr këtë:

V E N D I M

Riza Livoreka, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj-dega në Kaçanik, **nuk është përgjegjës** për shkeljen disiplinore të përcaktuar nga neni 5, paragrafi 2, pika 2.6, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Paneli hetimor i themeluar me vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me numër KGJK.nr.257/2020, të datës 18 nëntor 2020, për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/32/2020-AD/GJTHFR/ 02/20, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin mbi hetimin e bërë lidhur me shkeljen disiplinore të pretenduar të gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-dega në Kaçanik, i cili dyshohet se me rastin e vendosjes për lëndën C.nr.317/2020, nuk ka raportuar rastin e përjashtimit të mundshëm nga procedura siç kërkohet me ligj.

Sipas ankuesit gjyqtari Riza Livoreka duke qenë në lidhje familjare me palën paditës e ka aprovuar kërkesën dhe me aktvendim C.nr.317/2020, ka caktuar masën e përkohshme të sigurimit. Ky veprim i gjyqtarit Riza Livoreka nga parashtruesi i ankesës është konsideruar shkelje disiplinore të përcaktuara në neni 5, paragrafi 2, pika 2.6, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 24 mars 2021, ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore në të cilën morën pjesë kryesuesi i panelit hetimor gjyqtari Alajdin Tershnjaku dhe subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Riza Livoreka. Kryesuesi i panelit hetimor në fillim të seancës dhe në fjalën përfundimtare, deklaroi se qëndron pran raportit të bërë me shkrim dhe provave të bashkangjitura dhe ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që të vendos lidhur me pretendimet e Autoritetit Kompetent se a ka apo nuk ka pasur shkelje disiplinore nga gjyqtari Riza Livoreka më rastin e nxjerrjes së aktvendimit C.nr.317/2020, me të cilin aktvendim ka aprovuar kërkesën e palës paditës dhe ka caktuar masën e përkohshme të sigurimit, e që sipas pretendimit të ankuesit me palën paditës gjyqtari Livoreka është në lidhje familjare.

Gjyqtari Riza Livoreka në seancën dëgjimore deklaroj se qëndron në tërësi pranë deklaratave të dhëna te Autoriteti Kompetent dhe para panelit hetimor. Ka theksuar se lënda kontestuese i ishte ndarë sipas sistemit SMIL dhe gjatë asaj kohe ka qenë duke punuar në shtëpi për arsyeje shëndetësore dhe se për natyrën urgjente të lëndës është njoftuar nga pala. Me tutje ka deklaruar se pasi lënda ka qenë e natyrës urgjente ka nxjerr aktvendimin C.nr.317/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesën e palën paditëse dhe ka caktuar masën e përkohshme të sigurimit, dhe lëndën e kompletuar e kishte dorëzuar në gjykatë përmes referentit të gjykatës. Nuk qëndron pretendimi i ankuesit se me palën paditëse është në lidhje të afërt të gjakut e që sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore ka qenë i obliguar të kërkoj përjashtimin. Me gjithë këtë gjyqtari Livoreka ka theksuar se për të hequr çdo dilemë për njëanshmëri edhe pse nuk është në lidhje të afërt të gjakut me paditësen ka kërkuar nga Kryetari i gjykatës përjashtim dhe se kjo kërkesë e gjyqtarit Livoreka ishte miratuar nga Kryetari.

Me rastin e nxjerrjes e Aktvendimit C.nr.317/2020, sipas gjyqtarit Riza Livoreka nuk është kryer asnjë shkelje disiplinore e pretenduar nga ankuesi dhe e proceduar tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës nga Autoriteti Kompetent.

Për të vërtetuar drejt gjendjen faktike Këshilli Gjyqësorë i Kosovës administrojë provat materiale siç janë: padia me propozim për lëshimin e masës së përkohshme të sigurimit C.nr.317/20, Aktvendimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë C.nr.317/20 të datës 21.07.2020, Kërkesa e Gjyqtarit Riza Livoreka drejtuar Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj për përjashtimin lidhur me vendosjen në këtë çështje juridike të datës 21.08.2020, deklarata e gjyqtarit Riza Livoreka e datës 13.10.2020, Aktvendimi i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj për aprovimin e kërkesës për përjashtimin e Gjyqtarit Riza Livoreka për vendosjen në lëndën C.nr.317/20 i datës 27.08.2020, Ankesa e palës së paditu të datës 24.09.2020, kërkesa e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës për inicim të procedurës disiplinore të datës 23.10.2020.

Pas vlerësimit të gjitha provave një nga një dhe të gjithave së bashku, Këshilli Gjyqësor i Kosovës vlerësoj se nuk qëndron pretendimi i Autoritetit Kompetent se Gjyqtari Riza Livoreka me nxjerrjen e Aktvendimit C.nr.317/20, ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.6, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga provat e prezantuara nga panelit hetimor, përkatësisht nga shkresat e lëndës nuk është vërtetuar se gjyqtari Riza Livoreka me rastin e nxjerrjes se Aktvendimit C.nr.317/20, me të cilin ka miratuar kërkesën e palës paditës dhe ka caktuar masën e përkohshme të sigurimit, të këtë bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.6 të Ligjit për përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Është vërtetuar se gjyqtari Livoreka edhe pse me palën paditës është në lidhje familjare shume të largët kishte kërkuar nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj përjashtimin nga kjo lëndë të cilën kërkesë Kryetari i Gjykatës ja kishte miratuar.

KGJK-ja vlerëson se me këto veprime gjyqtari Riza Livoreka nuk ka bërë shkelje disiplinore të sanksionuar me Ligjin mbi Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, siç ka pretenduar ankuesi dhe Autoriteti Kompetent.

Nga sa u tha me lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.73/2021, datë: 24 mars 2021

Skender COÇAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimi të vendimit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Sahit Krasniqi, U.d. Kryetar, Gjykata Themelore në Ferizaj;*
- *Riza Livoreka, Gjyqtar, Gjykata Themelore në Ferizaj-dega në Kaçanik;*
- *Shkelzen Maliqi, Drejtor i Përgjithshëm i SKGJK-së;*
- *Arkivit.*